



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr/ 85/2011

Në bazë të nenit 40, neni 73 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ Nr.2008/10 për Organizimin dhe Funkcionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna, neni 30, 31 i Statutit të Komunës, mbështetur në rregulloren për punën e Komiteteve të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2011 merr këtë:

V E N D I M
P Ë R
MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR KOMITETE KONSULTATIVE

I

Merret vendimi për miratimin e planit të punës për tri Komitete Konsultative të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2011.

II

Në bazë të këtij plani planifikohen mbledhjet që do të mbahen për Komitetin për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, për Komitetin për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për Komitetin për Shërbime Publike dhe Emergjencë për vitin 2011.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Komiteti për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, Komiteti për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetin për Shërbime Publike dhe Emergjencë MAPL-ja dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data:30.06.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi

